

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Tonka Berishaj dhe Have Haliti, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve: R.A. për shkak të veprës penale-lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, M.D. dhe B.I., për shkak të veprave penale, secili veç e veç- mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së dhe veprën penale në bashkëkryerje- lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit M.D., av. F.G., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P nr. 495/09 të datës 13.11.2017, në seancën e kolegjit me dt. 23.03.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.D., av. F.G., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë P nr. 495/09 të datës 13.11.2017, vërtetohet.

Ndërsa, aktgjykimi i përmendur në pjesën ndëshkuese për të akuzuarin B.I., si dhe në pjesën refuzuese nuk u shqyrtua, sepse nuk kishte ankesë.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, P nr. 495/09 i datës 13.11.2017, konform dispozitës së nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit M.D. dhe B.I. janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale-mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së. Të akuzuarit M.D. gjykata i ka shqiptuar dënimin me gjobë, në shumën prej 2.000(dymijë) €, të cilin dënim mund ta paguajnë me këste(katër këste) dhe është i obliguar që ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë ditëve(15) nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak, prej datës 22.06.2009 deri me datën 22.07.2009 do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar, duke iu llogaritur për një ditë burgimi 20(njëzet) € të gjobës (ashtu që nga shuma prej 2000 € i hiqen shuma e të hollave e llogaritur në arrestin shtëpiak).

I akuzuari B.I. është gjykuar me dënim me gjobë, në shumë prej njëmijepesëqind (1500) €, të cilin dënim mund ta paguaj me këste(katër këste) duke filluar në afat prej

pesëmbëdhjetë ditësh(15) nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak, prej datës 22.06.2009 deri me datën 06.07.2009, i është llogaritur në dënimin e shqiptuar me gjobë duke ju llogarit një ditë nga masa e arrestit shtëpiak me 20(njëzet) € të gjobës (ashtu që nga shuma prej 1500 euro i hiqen shuma e të hollave e llogaritur në arrestin shtëpiak).

Nëse dënimi me gjobë, nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 € të gjobës.

Ndaj të akuzuarve është shqiptuar edhe dënim plotësues:

-Konfiskohen përgjithmonë sendet e luajtshme, si mjete që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale dhe sendet që i nënshtrohen automatikisht konfiskimit dhe atë:

-Arma-revole “GLOCK”, model 19 e kalibrit 9x19mm,e prodhuar në Austri, me numër serik KPS-293,një karikator me 5 plumba 9mm, nga i akuzuari M.D. dhe

-Pistoleta e tipit “SIG SAUER”, model P2220,e prodhuar në Zvicër, me nr.serik A1062693,e kalibrit 9x19 7.65mm,një karikator dhe 7 fishek të kalibrit 9x19mm,me baza të stampuara “S&B-9x19-08” 6 fishekë dhe MEN06-9x19”, një fishekë, nga i akuzuari B.I..

Të akuzuarit janë obliguar,secili veç e veç, që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 50(pesëdhjetë) €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ndaj të akuzuarit R.A. për shkak të veprës penale nga neni 328 par. 1 të KPK dhe ndaj të akuzuarve R.A., M.D. dhe B.I., për veprën penale, secili veç e veç, nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, konform nenit 363 par.1 pika 1.1 dhe 1.3 të KPKS-së, është refuzuar aktakuza sepse Prokurori i shteti ka hequr dorë nga ndjekja penale. Shpenzimet e procedurës penale për këto vepra bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Të dëmtuarit,N.A., Sh.U., S.M., F.G., M.A. dhe H.D., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

-Mbrojtësi i të akuzuarit M.D., av. F.G., për shkak të vendimit për sanksionin penal dhe i ka propozuar gjykatës që ankesën ta aprovojë si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë për të pandehurin M.D., vetëm sa i përket lartësisë së dënimit.

Prokurori i Shtetit me parashtrësën PPA. Nr. 58/18 të dt. 09.02.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.D., av. F.G., e parashtruar kundër aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Prishtinë ,Departamenti për Krime të Rënda,PKr.nr.495/2018 të datës 13.11.2017, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, ndërsa aktgjykimi i cekur të vërtetohet.

Gjykata e Apelit seancën e kolegjit e mbajti konform nenit 390 par. 1 të KPPK, në mungesë të palëve sepse kemi të bëjmë me aktgjykim me të cilin është shqiptuar dënimi me gjobë, andaj nuk është e nevojshme pjesëmarrja e palëve.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar edhe sipas detyrës zyrtare konformë dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Meqë aktgjyrimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, atëherë Gjykata e Apelit të njëjtin e vlerësoi në pajtim me dispozitën e nenit 394 par 1 të KPPK-së, sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale as shkelje tjera që kishin me kushtëzuar prishjen e tij.

Po ashtu gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, pasi që nuk lejohet ankesa për këtë bazë ankimore sipas nenit 383 par. 2 të KPK-së, meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe me këtë është pajtuar trupi gjykues, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimit ankimor.

Vendimi për dënimin.

Duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit gjen se ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.D., që ti shqiptohet një dënim më i but, është e pabazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.D., në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit dhe shqiptimit të dënimit këtij të akuzuari, nuk i ka marrë parasysh dhe nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit nga neni 74 të KPRK duke iu referua gjendjen ekonomike dhe rrethanat familjare të akuzuarit me pretendim se ai është mbajtës i familjes, baba i tre fëmijëve dhe po ashtu kujdeset edhe për familjen e vëllait i cili është i sëmur dhe mjekimi i të cilit është shumë i shtrenjte, ndërsa gjendja e tij ekonomike është e rëndë.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit M.D., i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese që ishin në anën e tij si: pranimin e fajësisë, premtimin se nuk do të përsërisë veprën penale, sinqeritetin e shprehur, se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin dhe gjendjen ekonomike të tij dhe më pas i ka shqiptuar dënimin në përputhje me këto rrethana. Vlerësimin e këtillë të rrethanave lehtësuese e pranon si të drejtë edhe Gjykata e Apelit dhe vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit M.D., është në përputhje me shkallën e përgjegjëses penale të tij, si kryerës, dhe në rrethana të këtilla nuk ekziston asnjë arsye që atij ti shqiptohet një dënim më i butë, siç pretendon mbrojtja, aq më parë kur me ankesë nuk theksohen rrethana të tilla që do të justifikonin një dënim më të butë. Përkitazi me rrethanat e pretenduara për gjendjen familjare të akuzuarit nuk është dëshmuar me asnjë provë konkrete as në shqyrtimin gjyqësor e as që janë bashkangjitur ankesës, ndërsa nga shënimet personale të akuzuarit

në shkresat e lëndës rezulton se vet i akuzuari ka deklaruar se është i gjendjes së mesme ekonomike. Për këto arsye u deshtë që ankesa përkitazi me vendimin për dënim të refuzohet si e pabazuar.

Nga se u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR. Nr. 55/2018 me 23.03.2018

Procesmbajtës

Anëtarët e kolegjit

Kryetar i kolegjit

Eroll Gashi

Tonka Berishaj

Fillim Skoro

Have Haliti
